



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË/ OPŠTINSKI SUD ZA PREKRŠAJE U  
PRIŠTINU/ MUNICIPAL MINOR OFFENCES COURT IN PRISHTINA

Nr.regj. 16958/10

GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË, duke vendosur në procedurën kundërvajtëse kundër të pandehurit Mazllum Belegu nga Prishtina, për kundërvajtje nga neni 16 paragrafi 1.1 i Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave të Zyrtarëve të lartë Publikë dhe Ligji nr. 3/L -151, e në bazë të nenit 73,74,195, 199, të LMK me dt. 18.08.2010 merrë këtë:

### AKTVENDIM

**I PANDEHURI:** Mazllum Nazmi Belegu, e lindur më 12.04.1945 në Pejë, tani më vendbanim në Prishtinë rr. Rifat Bugujeviq nr. 10/4, me profesion pensioner, i gjendjes së mesme ekonomike.

### Ë s h t ë p ë r g j e g j ë s

Sepse nuk e ka deklaruar pasurin për vitin 2009 deri me dt. 31.03.2010 në Agjensionin Kundër Korrupsionit në Prishtinë, Me veprim të tillë ka kryer veprë kundërvajtëse nga **16 paragrafi 1.1 i Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave të Zyrtarëve të lartë Publikë dhe Ligji nr. 3/L -151**, andaj për këtë:

### GJOBITET

Me gjobë në shumë prej 300 (treqind ) Euro, të cilën gjobë ka për të paguar në afat prej 15 ditësh pasi që aktvendimi të merrë formën e prerë, në dobi të AFQ i drejtësisë në Prishtinë, në gjirollogarin rrjedhëse 1000430070000518, nëse gjobën e shqiptuar nuk e paguan në afatin e dhënë e njejtë do ti zavendohej me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 20 ditësh, duke ia llogaritur nga 15 Euro në një ditë burgu.

Shpenzime të procedurës nuk ka patur, kurse në emër të paushallit gjyqësor është i obliguar të paguaj shumën prej 5 (pesë) Euro, në afat dhe xhirollogari të njëjtë me gjobën.

Nga një kopje të këtij aktvendimi ti dorëzohet të pandehurit dhe ushtruesit të kërkesës.

### A r s y e t i m

Agjensioni Kundër Korrupsionit, parashtror kërkesën nr.01/2284/10 të dt.15.06.2010 për fillimin e procedurës kundërvajtëse kundër të pandehurit të përmendur më lartë dhe për kundërvajtjen e lartcekur.

Gjatë procedurës i pandehuri Mazllum Belegu në deklaratë tij pohoj se që nga viti 2004 e kam filluar punën e drejtorit Ekzekutiv në Ministrinë e Shëndetësisë në Qendrën kombëtare të Kosovës për transfuzionin e gjakut të cilën post e kam mbajtur gjer me dt. 12.04.2010, ku qe nga kjo datë e kam arritur moshën e pensionimit, ku dhe jam pensionuar.

Ku si provë material gjykatës ja la vendimin e ndërprerjes së mardhanjës së punës, për shkak të arritjes së moshës së pensionimit. E vërteta është se formularin për paraqitjen e deklaratimit të pasurisë në Agjensionin kundër Korrupsionit e kam pranuar dikund kah fundi i marsit, por pasi qe unë isha në dijoni se do të pensionohem edhe pse e kam plotësuar formularin unë nuk e kam derzuar në Agjensionin kundër korrupsion. Pasi që është publikuar lista e mos paraqitjes së pasurisë, unë e kam qar formularin e plotësuar në Agjension por ata nuk ma kanë pranuar, përndryshe çdo vit ku është kërkuar paraqitja e pasurisë unë e kam paraqitur pasurin.

Me kërkesën e ushtruar si dhe marrjen në pyetje të pandehurit, Gjyqtarja në tërësi vërtetoi që i pandehuri ka bërë kundërvajtje me të cilën e rëndon kjo kërkesë, dhe si rrethanë lehtësuese morri parasysh se i lartpërmenduri është pensionuar me dt. 12.04.2010.

Kurse si rrethanë rënduese e marri parasysh kundërvajtjen qe e ka kryer, andaj për këtë e shpalli fajtor dhe e dënoi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Me rastin e shqiptimit të dënimit gjyqtari mori për bazë të gjitha rrethanat e parapara me nenin 7 të Ligjit mbi kundërvajtjet e posaçërisht peshën e kundërvajtjes së bërë, andaj ia shqiptoj këtë lloj të dënimit duke konsideruar se vetëm me këtë do të arrihet efekti pozitiv dhe se në të ardhmen do të shmanget nga kryerja e veprave të këtilla dhe të ngjashme. andaj u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi pala dhe ushtruesi i kërkesës ankesë mund ti ushtrohet Gjykatës së Lartë për Kundërvajtje në Prishtinë, në afat prej 8 ditësh, prej ditës së marrjes së këtij aktvendimi nëpërmjet të kësaj Gjykate dhe pa taksa.

**VENDOSI GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË  
GJYQTARI PËR KUNDËRVAJTJE**

Hateme Ajvazi

